VENDIM
Nr.51, datë 24.11.2010

PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË TË
UJËSJELLËS SHËRBIME KOMUNALE SHA KRASTË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë....." Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të licencohet operatori Ujësjellës Shërbime Komunale sh.a. Krastë me:
Drejtues ligjor z. Ibrahim Riza Gjoni
Drejtues teknik z. Hajredin Shemsi Murgu.
2. Operatori Ujësjellës Shërbime Komunale sh.a. Krastë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është komuna Martanesh, qyteti Krastë, fshati Gjon, Peshk, Lene Ndërfushës, Val Stoveç, Melcu.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 24.11.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi